

**Udhëzues i shpejtë**  
**4PW72362-1-23**

Udhëzimet origjinale janë në gjuhën angleze. Gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.  
Referojuni CD-së për manuale përdorimi më të detajuara.  
Instalimi: shikoni faqen 2.

**PËRDORIMI**

**1. Masa sigurie të përgjithshme**

Shikoni gjithashtu edhe manualin e përdorimit të dërguar me njësinë e brendshme dhe të jashtme.

Ju lutemi t'i lexoni me kujdes këto "1. Masa sigurie të përgjithshme" përpara instalimit të pajisjes për kondicionimin e ajrit dhe sigurohuni që ta instaloni saktë atë.

Mosndjekja e këtyre udhëzimeve në mënyrën e duhur mund të rezultojë në dëme materiale ose lëndim personi, të cilat mund të jenë serioze në varësi nga rethanat.

**PARALAJMËRIM**

**MOS** luani me njësinë ose me pultin e komandimit të saj. Vënia aksidentale në punë nga një fëmijë mund të rezultojë në dëmtim të funksioneve trupore ose në lëndim fizik.

**PARALAJMËRIM**

Asnjëherë mos e qmtoni pultin e komandimit. Prekja e pjesëve të brendshme mund të rezultojë në goditje elektrike ose në zjarr. Konsultohuni me shitësin e Daikin ose me përfaqësuesin e autorizuar për inspektimet e brendshme dhe rregullimet.

**PARALAJMËRIM**

Për të shmangur goditjen elektrike, mos e përdorni me duar të lagura.

**PARALAJMËRIM**

**MOS** modifikoni ose mos riparoni pultin e komandimit. Kjo mund të rezultojë në goditje elektrike ose në zjarr. Konsultohuni me shitësin e Daikin.  
**MOS** i ndryshoni vendndodhjen ose mos riinstaloni vetë pultin e komandimit. Instalimi i gabuar mund të rezultojë në goditje elektrike ose në zjarr. Konsultohuni me shitësin e Daikin.  
**MOS** përdorni pranë pajisjes materiale të ndezshme (p.sh. llak për flokët ose insekticide). Mos e pastroni pajisjen me tretës organikë, si p.sh. hollues boje. Përdorimi i tretësve organikë mund të shkaktojë dëmtime plasaritjeje në pajisje, goditje elektrike ose zjarr.

**2. Karakteristikat dhe funksionet**

BRC1E52B7 është pult komandimi i teknologjisë së fundit, i cili ofron kontroll të plotë mbi pajisjet tuaja të instaluara.

**1 PULTI BAZË I KOMANDIMIT**

Funksionet bazë të pultit të komandimit janë:

- Ndezja/Fikja,
- ndryshimi i regjimit të funksionimit,
- rregullimi i temperaturës,
- rregullimi i vëllimit të ajrit,
- rregullimi i drejtimit të fryrjes së ajrit.

**2 FUNKSIONI I ORËS**

Funksionet e orës janë:

- ora në kohë reale me 12/24 orë,
- ora zyrtare verore automatike.

**3 FUNKSIONI I PROGRAMIMIT**

Funksionet e kohëmatësit të programimit janë:

- programimi maksimali deri në 5 veprime për çdo ditë të javës,
- programimi i 3 programeve të pavarura,
- aktivizimi/çaktivizimi i programit në çdo kohë,
- të lidhura me një temperaturë ftohjeje dhe/ose ngrohjeje ose me një veprim fikjeje (me ose pa temperaturë rikthimi),
- përparësia e "komandës së fundit" kundrejt komandës së mëparshme deri në komandën e ardhshme të programuar.

**4 RIKTHIMI**

Funksioni i rikthimit e mban temperaturën e ambientit në një diapazon të caktuar kur nuk ka persona të pranishëm dhe kondicionimi i ajrit është fikur.


**5 BUTONI/FUNKSIONI I NDALIMIT**

Butonat dhe/ose funksionet mund të bllokohen për të kufizuar veprimin e përdoruesit.

**6 MUNDËSIA E AFISHIMIT TË DETAJUAR**

Funkcion shtesë i mundshëm për të afishuar temperaturën e jashtme ose të brendshme.

**3. Emërtimi dhe funksioni i çelësave**



1 BUTONI I ZGJEDHJES SË REGJIMIT TË FUNKSIONIMIT  
Për të zgjedhur regjimin e funksionimit që dëshironi.

2 BUTONI I VENDOSJES SË DREJTIMIT TË FRYRJES SË AJRIT/SHPEJTËSISË SË VENTILATORIT  
Për të hyrë në ekranin e vendosjes së drejtimit të fryrjes së ajrit/shpejtësisë së ventilatorit.

3 BUTONI MENYJA/ENTER  
Për të hyrë të Menyja kryesore ose të zëri i zgjedhur i cilësimit.

4 BUTONI LART/POSHTË  
Për të rritur/ulur temperaturën e vendosur, për të theksuar zërin ngjitur në anën e sipërme/të poshtme ose për të ndryshuar zërin e zgjedhur.

5 BUTONI MAJTAS/DJATHTAS  
Për të theksuar zërin ngjitur në anën e majtë/të djathtë.

6 BUTONI I NDEZJES/FIKJES  
Për të nisur ose për të ndaluar sistemin.

**INFORMACION**  
Ky është butoni i vetëm që punon kur ndriçimi në sfond nuk është i ndezur.



7 LLAMBA E FUNKSIONIMIT  
Ndrizon gjatë punës ose pulson nëse ndodh një defekt.

8 BUTONI ANULO  
Për t'u rikthyer në pamjen e mëparshme të ekranit.

9 Ekran LCD (me ndriçim në sfond)  
Kur shtypet ndonjë buton funksionimi, ndriçimi në sfond ndriçon për rreth 30 sekonda. Kur 1 njësi e brendshme komandohet nga 2 pulte komandimi, ndriçimi në sfond do të ndriçojë në pultin e komandimit që është përdorur i pari.

**4. Emërtimi dhe funksioni i ikonave**

Për të bërë ndryshimin midis afishimit standard dhe afishimit të detajuar mund të referoheni te "15.2 Zgjedhja Mënyra e afishimit".



1 REGJIMI I FUNKSIONIMIT  
Tregon regjimin aktual të funksionimit (Ftohje, Ngrohje, Ajrimi, Ventilat., Tharje, ose Auto).

2 SHPEJTËSIA E VENTILATORIT  
Tregon shpejtësinë e ventilatorit që është vendosur për kondicionerin e ajrit. Nëse kondicioneri i ajrit nuk e ka funksionin e kontrollit të shpejtësisë së ventilatorit, atëherë shpejtësia e ventilatorit nuk do të afishohet.

3 AFISHIMI I TEMPERATURËS SË VENDOSJES/RIKTHIMIT  
Kur njësi është e ndezur, **Vendosur** tregon temperaturat që janë vendosur për kondicionerin e ajrit.  
Kur njësi është e fikur, **Rikthimi** tregon temperaturat që janë vendosur për funksionin e rikthimit.

4 SHKRIRJE/NISJE E NXEHTË  
Tregon se është aktiv regjimi shkriërje/nisje e nxehtë.

5 MESAZHI  
Mesazhet mund të afishohen.

6 AJRIMI/PASTRIMI  
Ikonat e regjimit të ajrimit tregojnë regjimin aktual të ajrimit (vetëm HRV) (AUTOMATIK, AJRIM RIKUP. ENERJ., ANASHKA.).

Ikona e njësisë së pastrimit të ajrit tregon se njësi për pastrimin e ajrit (opsion) është duke punuar.

7 AFISHIMI  
Tregon se është vendosur bllokimi i tasteve ose që ndalohet përdorimi i butonit të menjse.

8 AFISHIMI  
Tregon që kohëmatësi i programit ose kohëmatësi i fikjes është i aktivizuar.

9 AFISHIMI  
Tregon që duhen vendosur ora. Funksioni i kohëmatësit të programit nuk do të funksionojë derisa të vendoset ora.

10 IKONA E KONTROLLIT TË JASHTËM  
Tregon që një tjetër pult komandimi me prioritet më të lartë po kontrollon ose po çaktivizon pultin tuaj të komandimit.

11 IKONA E RIKTHIMIT  
Pulson kur njësi ndizet me kontrollin e rikthimit.

12 DREJTIMI I FRYRJES SË AJRIT  
Afishohet kur vendoset drejtimi i fryrjes së ajrit ose opsioni i lëkundjes së fletëve.

13 ORA (orë me kohë reale me afishim 12/24 orë)  
Afishohet kur është vendosur ora. Nëse ora nuk është vendosur, shfaqet - : -.

14 ZGJEDHJA E DETAJUAR  
Afishohet kur zgjidhen zërat e afishimit të detajuar.

- 5. Përshkrimi i regjimeve të funksionimit**
- 1 FUNKSIONIMI VETËM VENTILATOR  
Në këtë regjim pune, ajri vetëm qarkullon pa u ngrohur ose pa u ftohur.
  - 2 FUNKSIONIMI THARJE  
Në këtë regjim pune, lagështia e ajrit do të ulet me një rënie minimale të temperaturës. Temperatura dhe shpejtësia e ventilatorit kontrollohen automatikisht dhe nuk mund të komandohen nga pulti i komandimit. Funksionimi tharje nuk do të punojë nëse temperatura e brendshme është shumë e ulët.
  - 3 FUNKSIONIMI AUTOMATIK  
Në këtë regjim pune, komanduesi do të bëjë shkëmbim automatik midis ngrohjes dhe ftohjes sipas kërkesës nga vlera e caktuar.
  - 4 FUNKSIONIMI FTOHJE  
Në këtë regjim pune, ftohja do të aktivizohet sipas kërkesës nga vlera e caktuar ose nga funksionimi i kufizuar.
  - 5 FUNKSIONIMI NGROHJE  
Në këtë regjim pune, ngrohja do të aktivizohet sipas kërkesës nga vlera e caktuar ose nga funksionimi i rikthimit.
  - 6 AJRIMI (vetëm HRV)  
Regjimi i ajrimit vë në punë HRV-në; referojuni manualit të HRV-së për më shumë detaje.

- 7. RIKTHIMI**
- RIKTHIMI është një funksion që bën të mundur mbajtjen e temperaturës së dhomës brenda një diapazoni specifik kur nuk ka persona në dhomë dhe kondicionimi i ajrit është i fikur.
- Nëse temperatura e dhomës bie nën 10°C, fillon automatikisht funksionimi i ngrohjes. Menjëherë sapo arrihet temperatura 12°C, komanduesi rikthehet në gjendjen e tij fillestare.
  - Nëse temperatura e dhomës shkon mbi 35°C, fillon automatikisht funksionimi i ftohjes. Menjëherë sapo arrihet temperatura 33°C, komanduesi rikthehet në gjendjen e tij fillestare.
- Diferenca mund të rregullohet në mënyrë e konfigurimit Rikthimi. Temperatura e rikthimit mund të vendoset kur njësi fiket në pamjen bazë të ekranit ose të vendoset në program.

- 6. Metoda bazë e përdorimit**
- a Regjimi i funksionimit
  - b Temperatura:
    - Kur njësi është e ndezur, **Vendosur** tregon temperaturat që janë vendosur për kondicionerin e ajrit.
    - Kur njësi është e fikur, **Rikthimi** tregon temperaturat që janë vendosur për funksionin e rikthimit.
  - c Shpejtësia e ventilatorit/drejtimi i fryrjes së ajrit

1 Shtypni disa herë derisa të zgjidhet regjimi i funksionimit që dëshironi Ftohje, Ngrohje, Ajrimi, Ventilat., Tharje ose Auto.

2 Shtypni Llamba e funksionimit ndriçon dhe sistemi fillon të funksionojë.

3 Përdorni për të vendosur temperaturën.

**INFORMACION**  
Kur është në regjimin Tharje ose Ajrimi, shpejtësia e ventilatorit nuk mund të vendoset.

4 Shtypni  
5 Përdorni për të zgjedhur shpejtësinë e ventilatorit ose cilësimin e drejtimit të fryrjes së ajrit.



6 Kur të keni zgjedhur cilësimin e shpejtësisë së ventilatorit, përdorni për të zgjedhur shpejtësinë e dëshiruar midis opsioneve E ulët, Mesatare, ose E lartë.

**INFORMACION**  
Kur është në regjimin Tharje ose Ajrimi, shpejtësia e ventilatorit nuk mund të vendoset.

7 Kur të keni zgjedhur cilësimin e drejtimit të fryrjes së ajrit, përdorni për ta ndryshuar cilësimin midis opsioneve **Lëkundje, Pozicion 0, Pozicion 1, Pozicion 2, Pozicion 3, dhe Pozicion 4.**




8 Shtypni për të afishuar pamjen bazë të ekranit.

9 Shtypni Llamba e funksionimit do të fiket dhe sistemi ndalon funksionimin.

**Karakteristika shtesë të panelit e komandimit: BLOKIMI I TASTEVE**

1 Mbani shtypur për 4 sekonda për të aktivizuar regjimin e bllokimit të tasteve. Shfaqet ikona e bllokimit të tasteve.



2 Për ta anuluar regjimin e bllokimit të tasteve, mbani përsëri shtypur për 4sekonda. Ikona e bllokimit të tasteve zhduket.

**7. Përshkrimi i zërave te menyja kryesore**

- 1 DREJT. FRYRJA AJRIT (vetëm nëse është instaluar funksioni individual i fryrjes së ajrit)  
Për të vendosur Drejt. fryrja ajrit në mënyrë individuale për secilën nga 4 fletët e fryrjes.
- 2 NISJE E SHPEJTË (vetëm SkyAir)  
Për ta vendosur shpejt temperaturën e dhomës në një temperaturë të përshtatshme.
- 3 AJRIMI  
Për të vendosur shpejtësinë e ajrimit dhe regjimin e tij (vetëm HRV).
- 4 OPSIO. PËR KURSIM ENERJIE  
Kjo ju lejon të kufizoni diapazonin e temperaturës së vendosjes dhe afishon konsumin e energjisë elektrike.
- 5 **Vend. kufiri vlerave**  
Kufiri i temperaturave të vendosjes mund të kufizohet. Është e mundur që të kufizohet kufiri i temperaturave në bazë të një modeli dhe të regjimit të funksionimit.
- 6 **Sensori ndiju. (ulët)** (Vetëm nëse është instaluar sensor i ndijues)  
Ky ju lejon që të bëni një konfigurim, i cili ndryshon automatikisht temperaturën e synuar të kondicionimit të ajrit kur nuk zbulohen lëvizje personash përgjatë një kohe të caktuar. Nëse zbulohen lëvizje personash, ai rikthehet në temperaturën normale të vendosur.
- 7 **Sensori ndiju. (stop)** (Vetëm nëse është instaluar sensor i ndijues)  
Ky ju lejon që të bëni një konfigurim, i cili ndalon automatikisht funksionin e kondicionimit të ajrit kur nuk zbulohen lëvizje personash përgjatë një kohe të caktuar.
- 8 **Riven. auto i vlerës**  
Përdoret për të rikthyer temperaturën e paravendosur pas kalimit të një periudhë të caktuar kohore, edhe nëse temperatura e vendosur është ndryshuar.
- 9 **Kohëmatësi i fikjes**  
Ky ju lejon që ta vendosni çdo periudhë të funksionimit të sistemit në një interval kohor 30–180 minuta. Sistemi fiket automatikisht pas përfundimit të kohës së zgjedhur (sa herë që sistemi është i aktivizuar).
- 10 **Konsumi i energjisë**  
Këtu shfaqet një tregues i konsumit të energjisë elektrike deri në atë moment. Kjo bën të mundur që konsumatori të vlerësojë tendencën e konsumit të energjisë. **Shënim:** Disponueshmëria e funksionit varet nga lloji i njësisë së brendshme. **Shënim:** Ky funksion nuk disponohet nëse me pultin e komandimit lidhet në grup më shumë se 1 njësi e brendshme. **Shënim:** Konsumi i afishuar i energjisë elektrike nuk është rezultat i matjes së kWh, por vjen si rezultat nga një llogaritje me të dhënat e kohës së punës së njësisë. Në këtë llogaritje disa faktorë janë vlera absolute, por faktorët e tjerë dalin thjesht si rezultat nga interpolimet me toleranca. Kjo shpjegon arsyen përse leximi mund të devijojë nga konsumi aktual i energjisë elektrike.

6 PROGRAMI  
Për të vendosur kohën e nisjes dhe kohën e ndalimit të funksionimit për çdo ditë të javës. Ekziston mundësia që të programohen deri në 5 veprime për çdo ditë. Mund të zgjidhen të dy regjimet e funksionimit (normal dhe rikthimi). Gjithashtu, mund të vendosen cilësimet për ditët pushim, si dhe nr. i programit.

6 INFORMAC. I MIRËEMBAJTJES  
Përdoret për të afishuar kontaktin për shërbimin dhe informacionin e modelit.

7 KONFIGURIMI  
Për të vendosur kontrastin e ekranit LCD. Gjithashtu mund të bëni shkëmbimin midis afishimit standard dhe atij të detajuar. Kur zgjidhet afishimi i detajuar, cilësimet e këtij afishimi mund të ndryshohen.

8 CILËSIMET AKTUALE  
Këto tregojnë një listë të cilësimeve aktuale për të gjithë zërat e mundshëm të menjse.

9 ORA DHE KALENDARI  
Kjo ju lejon të vendosni orën dhe datën. Ora mund të afishohet në format me 12 orë ose në format me 24 orë.

10 GJUHA  
Kjo ju lejon të vendosni gjuhën e afishimit.

**8. Drejtimi i fryrjes së ajrit**

Për informacion të detajuar mund t'i referoheni manualit të përdorimit në CD.

**9. Nisje e shpejtë (vetëm SkyAir)**

- 1 Hapni **Menyja kryesore** dhe vazhdoni me hapin (9) për të afishuar pamjen bazë të ekranit (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").
- 2 **Nisje e shpejtë** do të shfaqet në pamjen bazë të ekranit kur funksioni Nisje e shpejtë është i ndezur.

**INFORMACION**  
Përsëritni këtë procedurë për ta fikur funksionin Nisje e shpejtë.

**10. Cilësimi Ajrimi**

Vetëm në rast se është lidhur një HRV. Referojuni manualeve të HRV-së për më shumë informacion.


**11. Opsio. për kursim energjie**

Për informacion të detajuar mund t'i referoheni manualit të përdorimit në CD.

**12. Programi**

**12.1 Aktivizimi/çaktivizimi i programit**

- 1 Hapni pamjen e ekranit **Aktivizo/Çaktivizo** (12.1) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").
- 2 Përdorni për ta ndryshuar cilësimin në **Aktivizo** ose **Çaktiviz.**




3 Shtypni për të afishuar pamjen e ekranit të konfirmimit.

4 Përdorni për të zgjedhur **Po** dhe shtypni.

**12.2 Zgjedhja e numrit të programit**

- 1 Hapni pamjen e ekranit **Vendosja e nr. të program.** (11.2) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").
- 2 Përdorni për ta ndryshuar cilësimin në **Programi nr. 1, Programi nr. 2, ose Programi nr. 3.**




3 Shtypni për të afishuar pamjen e ekranit të konfirmimit.

4 Përdorni për të zgjedhur **Po** dhe shtypni.

**12.3 Përdorimi i ditëve të pushimit**

Kohëmatësi i programit do të jetë i çaktivizuar në ditët që janë vendosur si pushim.

- 1 Hapni pamjen e ekranit **Pushimet** (12.3) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").
- 2 Përdorni për të zgjedhur ditën që dëshironi. Shtypni për ta afishuar dhe për ta vendosur ditën e pushimit.



3 Shtypni për të afishuar pamjen e ekranit të konfirmimit.


4 Përdorni për të zgjedhur **Po** dhe shtypni.

**12.4 Ndryshimi i cilësimeve të programit të nr. të zgjedhur të programit**

Kohëmatësi i programit do të jetë i çaktivizuar në ditët që janë vendosur si pushim.

- 1 Hapni pamjen e ekranit **Cilësimet** (12.4) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").
- 2 Përdorni për të zgjedhur ditën që dëshironi (1).

3 Përdorni për të theksuar opsionin **Koha** e nisjes së funksionimit dhe për të vendosur kohën që dëshironi te opsioni **Koha e nisjes** së funksionimit (2).



4 Përdorni për të theksuar veprimin dhe për të zgjedhur veprimin që dëshironi te **Vep.**



**INFORMACION (kolona Vep.)**

Ka 3 lloje veprimesh:

1. Mund të konfigurohen vlerat e caktuara të temperaturës.
2. Mund të konfigurohen vlerat e caktuara të temperaturës së rikthimit.
3. Vlerat e caktuara të temperaturës dhe ato të temperaturës së rikthimit çaktivizohen.

5 Përdorni për të theksuar temperaturën dhe për të zgjedhur vlerën që dëshironi.

**INFORMACION (kolona Ftohje dhe Ngrohje)**

Tregon që njësi është specifikuar vlera e caktuar e temperaturës për ftohjen/ngrohjen dhe vlera e caktuar e temperaturës së rikthimit për këtë periudhë kohore. Në këtë rast do të përdoret vlera e caktuar që ka qenë aktive e fundit.

--: Tregon që funksioni i rikthimit është çaktivizuar për këtë periudhë kohore me veprimin e fikjes.

**13. Vetëpastrim filtri**

Ky funksion është i disponueshëm vetëm në modelin paneli i të cilit ka funksion të pastrimit automatik të filtrit. Duhet të vendoset kur funksionimi është i çaktivizuar.

**14. Informac. i mirëmbajtjes**

- 1 Hapni pamjen e ekranit **Informac. i mirëmbajtjes** (14) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").
- 2 Numri i telefonit të **Informacioni i kontaktit** do të shfaqet në krye të ekranit. Informacioni i modelit i **Njësisë brenda** dhe i **Njësisë jashtë** i produktit tuaj do të shfaqet në pjesën e poshtme të ekranit.

3 Shtypni për t'u rikthyer te **Menyja kryesore.**

**15. Konfigurimi**

**15.1 Zgjedhja e Ndalimi i rrymës së ajrit**



3 Shtypni për ta konfirmuar cilësimin. Shfaqet pamja bazë e ekranit.

### 15.4 Rregullimi i kontrastit i ekranit LCD

1 Hapni pamjen e ekranit të cilësimeve **Rregullimi i kontrastit** (15.4) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").

2 Përdorni për ta ndryshuar kontrastin.



3 Shtypni për ta konfirmuar cilësimin.

### 16. Cilësimet aktuale

1 Hapni pamjen e ekranit **Lista e statusit të cilësimeve** (16) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").

2 Shfaqet një listë me statusin e cilësimeve aktuale.


3 Shtypni për t'u rikthyer te **Menyja kryesore**.

### 17. Ora dhe kalendari

#### 17.1 Vendosja e Data dhe koha

1 Hapni pamjen e ekranit të cilësimeve **Data dhe koha** (17.1) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").

2 Përdorni për ta zgjedhur dhe për të vendosur **Viti**, **Muaji**, **Data**, si dhe **kohën**.



3 Shtypni për të afishuar pamjen e ekranit të konfirmimit.

4 Përdorni për të zgjedhur **Po** dhe shtypni .

#### 17.2 Vendosja e formatit të orës (12/24 orë)

1 Hapni pamjen e ekranit të cilësimeve **Orë 12H/24H** (17.2) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").

2 Përdorni për të zgjedhur **12H** ose **24H**.

3 Shtypni për të afishuar pamjen e ekranit të konfirmimit.

4 Përdorni për të zgjedhur **Po** dhe shtypni .

### 18. Gjuha


1 Hapni pamjen e ekranit **Gjuha** (18) (Mund të referoheni te "20. Struktura e menysë kryesore" dhe "Shtojca").

2 Përdorni për të zgjedhur gjuhën.

3 Shtypni për ta konfirmuar cilësimin. Shfaqet pamja bazë e ekranit.

### 19. Afishimi i kodit të gabimit

1 Nëse ndodh ndonjë gabim, në pamjen bazë të ekranit do të pulsojë mesazhi **Gabim: Shtyp butonin Menyja** ose **Paralaj: Shtyp butonin Menyja**.



2 Shtypni . Do të pulsojë gjithashtu edhe kodi i gabimit, si dhe do të shfaqet **Informacioni i kontaktit** dhe **informacioni i modelit**.

### 20. Struktura e menysë kryesore

Shikoni te "Shtojca".

## INSTALIMI

Referojuni CD-së për manuale instalimi më të detajuara.

#### 1. Masa sigurie të përgjithshme

Lexoni me kujdes këto udhëzime përpara instalimit. Ato ju tregojnë si ta instaloni, ta konfiguroni dhe si ta përdorni njësitë në mënyrën e duhur. Ruajeni manualin në një vend praktik për ta përdorur si referencë në të ardhmen.

Ky është një opsion për t'u përdorur në kombinim me njësitë Daikin. Referojuni manualit të instalimit dhe përdorimit të njësisë, për udhëzimet e instalimit dhe të përdorimit.

Ju lutemi t'i lexoni me kujdes këto "1. Masa sigurie të përgjithshme" përpara instalimit të pultit të komandimit.

Instalimi i gabuar ose shtimi i pajisjeve ose aksesoreve mund të rezultojë në goditje elektrike, qark të shkurtër, rrjedhje, zjarr ose në dëmtime të tjera të pajisjes ose në lëndim personi.

Nëse nuk jeni të sigurt për procedurat e instalimit ose përdorimin e tij, kontakti gjithmonë me shitësin tuaj për këshillim dhe informacion.

**MOS** e instaloni vetë pultin e komandimit. Instalimi i gabuar mund të rezultojë në goditje elektrike ose në zjarr. Konsultohuni me shitësin e Daikin.




Të gjitha instalimet elektrike në vend dhe përbërësit duhet të instalohen nga një specialist dhe duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi.



#### NJOFTIM

Kur përdoret termo funksioni i pultit të komandimit, zgjidhni vendin e instalimit duke marrë në konsideratë faktin që ai duhet të jetë një vend:

- ku mund të zbulohet temperatura mesatare e ambientit,
- që nuk është i ekspozuar ndaj dritës së diellit,
- që nuk ndodhet pranë një burimi nxehtësie,
- që nuk ndikohet nga temperatura e ajrit të jashtëm ose nga rrymat e ajrit, p.sh. për shkak të hapjes/ mbylljes së derës,
- Ku ekrani të mbahet i pastër.
- Ku pjesa ballore të mbahet e pastër.
- Ku temperatura është midis -10°C dhe 50°C.
- ku lagështia relative është maksimumi 95%.



#### NJOFTIM

- MOS** e instaloni pultin e komandimit:
  - Pranë pajisjeve që emetojnë rrezatim elektromagnetik. Rrezatimi elektromagnetik mund të ndërhyjë në funksionimin e sistemit të kontrollit dhe të shkaktojë një funksionim të parregullt të njësisë.
  - Në zona të lagështa ose në vende ku ai mund të ekspozohet ndaj ujit. Nëse uji futet në pultin e komandimit, ai mund të shkaktojë goditje elektrike dhe pjesët e brendshme elektronike mund të prishen.

Pasi të përfundoni instalimin:


- kryeni një provë funksionimi për të kontrolluar për defekte,
- shpjegojini klientit sesi ta përdorë pultin e komandimit, duke përdorur seksionin Përdorimi të këtij udhëzuesi të shpejtë,
- kërkoni klientit që ta ruajë CD-në dhe udhëzuesin e shpejtë për ta përdorur si referencë në të ardhmen. CD-ja përmban informacion të detajuar për instalimin dhe përdorimin.



#### PARALAJMËRIM


Konsultohuni me shitësin tuaj lokal lidhur me ndryshimin e vendndodhjes dhe riinstalimin e pultit të komandimit.

### 2. Lista e materialeve në kuti




- 1 Pulti i komandimit
- 2 Vida druri+flutura për në mur
- 3 Vida të vogla
- 4 Mbërthyes
- 5 CD e manualit
- 6 Udhëzuesi i shpejtë
- 7 Mbjajtësja e kablove

### 3. Heqja e pjesës së sipërme e pultit të komandimit




Futni një kaçavidë me kokë petashuqe në kanalet (1) në pjesët e poshtme të pultit të komandimit (2 vende) dhe hiqni pjesën e sipërme të pultit të komandimit.



#### NJOFTIM

Qarku elektronik i stampuar (PCB) është i montuar në pjesën e sipërme të pultit të komandimit. Bëni kujdes të mos e dëmtoni qarkun me kaçavidën petë.

### 4. Mbërthimi i pultit të komandimit



- 1 Për montim të ekspozuar, mbërthejeni me 2 vidat e drurit (Ø3,5x32) dhe fluturat e dërguara.
- 2 Për montim rrafsh me murin, mbërthejeni me 2 vidat e gjata (M4x16) të përfshira.

Për kutinë e çelësave të furnizuar në terren, përdorni aksesorin opsional KJB111A ose KJB211A.







#### INFORMACION

Vendoseni mbi një sipërfaqe të rrafshët. Bëni kujdes të mos prishni formën e pllakës së pasme të pultit të komandimit duke i shtrënguar vidat e mbërthimit më shumë sesa nevojitet.

### 5. Lidhja e telave të njësisë së brendshme


Ekzistojnë 4 mënyra:

- 1 nga prapa,
- 2 majtas,
- 3 lart,
- 4 lart në qendër.



- 1 njësisë e brendshme
- 2 Pritni me pinca pjesën e vendit ku do të kalojnë përmes telat elektrikë.
- 3 siguroni telat elektrikë në kapakun e sipërm duke përdorur mbajtësen e kablove dhe mbërthyesen.

Lidhni terminalat në pultin e komandimit (P1, P2) dhe terminalat e njësisë së brendshme (P1, P2). (P1 dhe P2 nuk kanë polaritet.)




#### INFORMACION

Kur të bëni instalimin, shtrijoni telat larg nga instalimet e furnizimit me energji elektrike për të shmangur marrjen e zhurmës elektrike (zhurmës së jashtme).


#### Specifikimet e telave

| Lloji i telit                           | Madhësia                  | Gjatësia totale |
|---|---------------------------|-----------------|
| Tel ose kablo me veshje plastike vinili | 0,75-1,25 mm <sup>2</sup> | ≤500 m          |



#### INFORMACION

1. Zhvishni veshjen e pjesës që duhet të kalojë përmes pjesës së brendshme të kutisë së pultit të komandimit (L). Referohuni te figura dhe tek tabela më poshtë. Është e rëndësishme që të ruhet një izolim i dyfishtë deri te kanali i kutisë së pultit të komandimit.
2. Për një instalim të lehtë është mirë që të ruhet një diferencë ±10 mm në gjatësinë e të 2 telave.




| Dalja e telave       | L       |
|----------------------|---------|
| Dalja lart           | ±150 mm |
| Dalja lart në qendër | ±200 mm |

### 6. Rivendosja e pjesës së sipërme e pultit të komandimit




#### NJOFTIM

Bëni kujdes të mos pickoni telat elektrikë kur të bëni vendosjen.



Vini në vije të drejtë kapakun e sipërm me foletë e kapakut të poshtëm (6 pika), futeni dhe montoni kapakun e sipërm. Në fillim fillojeni përshtatjen nga kapëset në pjesën e poshtme.



#### NJOFTIM

1. Kutia e çelësave dhe telat për lidhjen nuk përfshihen.
2. Mos e prekni direkt me dorë PCB-në.

### 7. Lidhja e energjisë/ndezja

- 1 Lidhni energjinë elektrike.
- 2 Duke kontrolluar lidhjen. Të lutem prit. afishohet në ekran.
- 3 Pas disa sekondash shfaqet pamja bazë e ekranit.

#### Nëse komandoni 1 njësi të brendshme ose 1 grup njësisë të brendshme me 2 pulte komandimi

- 1 Lidhni energjinë për të dy pultet e komandimit.
- 2 Vendosni se cili pult do të jetë pulti kryesor/dytësor i komandimit.
- 3 Kur mesazhi **Kodi i gabimit:U5 - Duke kontrolluar lidhjen. Të lutem prit.** shfaqet në të dy pultet e komandimit, shtypni dhe mbani shtypur për 4 sekonda butonin në pultin dytësor të komandimit.
- 4 Tani në pultin dytësor të shfaqet mesazhi **Pulti dytësor**.



#### INFORMACION

Pulti kryesor afishon ende mesazhin **Pulti kryesor**.

5 Pas disa sekondash shfaqet pamja bazë e ekranit.

Referojuni CD-së për udhëzime më të detajuara instalimi lidhur me:


- Cilësimet e fushave,
- Metodën e procesit të testimit (në rastin e SkyAir),
- Procedurën e kontrollit të Historia e gabimeve,
- Metodën e regjistrimit të Kontakti i mirëmbajtjes,
- Konfirmimin e detajeve të regjistruara,
- Ora dhe kalendari (shikoni edhe "17. Ora dhe kalendari" Në faqen 2),
- Gjuha (shikoni edhe "18. Gjuha" Në faqen 2),
- Butonat e ndalimit,
- Ndalimi i funksionit.

## MIRËMBAJTJA

### 1. Masa sigurie të përgjithshme


Fshijeni ekranin LCD dhe pjesët e tjera të sipërfaqes së pultit të komandimit me një leckë të thatë kur ato bëhen pis.

Nëse papastëritë në sipërfaqe nuk hiqen, njomeni leckën në një detergjent neutral të tretur në ujë, shtrydhni leckën fort dhe pastroni sipërfaqen. Pastaj fshijeni sipërfaqen me një leckë të thatë.




#### PARALAJMËRIM

Mos përdorni hollues boje, tretës organik ose ndonjë acid të fortë.



#### PARALAJMËRIM

Mos e lani pultin e komandimit. Ky veprim mund të shkaktojë rrjedhje elektrike dhe mund të rezultojë në goditje elektrike ose zjarr.



#### PARALAJMËRIM

Sigurohuni që gjatë kohës së mirëmbajtjes të ndaloni funksionimin e kondicionerit të ajrit dhe të fikni automatikisht e furnizimit me energji. Mosveprimi në këtë mënyrë mund të rezultojë në goditje elektrike ose në zjarr.

### 2. Rivendosja e shenjës së filtrit

- 1 Kur njëri nga mesazhet në vijim (**Koha për pastrim filtri**, **Koha e pastr. filtri&elementi**, ose **Koha për pastrim elementi**) shfaqet në pjesën e poshtme të pamjes bazë të ekranit, filtri duhet pastruar.
- 2 Pasi filtri ose elementi të jetë larë, të jetë pastruar ose të jetë zëvendësuar, shtypni për të hyrë te **Menyja kryesore**.
- 3 Përdorni për të zgjedhur **Rivendos treguesin e filtrit** dhe shtypni për ta rivendosur shenjën e filtrit.

## SHTOJCA

